



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më	
Nr.	prot.

Data: 10.3.2025

Nr: 250

Ora: 13:00

VENDIM

PËR

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 192, DATË 5.11.2024, TË
KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE, “PËR MIRATIMIN E
PROGRAMIT PËR TRAJNIMIN DHE MONITORIMIN E ADMINISTRATËS
ZGJEDHORE DHE TË DISA AKTORËVE TË TJERË, PËR ZGJEDHJET PËR
KUVEND 2025”**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “b” e “gj”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

VENDOS:

I. Në vendimin nr. 192, datë 5.11.2024, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për miratimin e programit për trajnimin dhe monitorimin e administratës zgjedhore dhe të disa aktorëve të tjerë, për Zgjedhjet për Kuvend 2025”, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Pika 6, e kreut X, ndryshohet si më poshtë vijon:

“6. “Kohëzgjatja e trajnimit për anëtarët e KZAZ-ve do të jetë 4 orë, ndërsa për kryetarët dhe sekretarët e KZAZ-ve, KQZ organizon trajnim të përqendruar me kohëzgjatje 6 orë (e ndarë në 2 sesione). Kohëzgjatja e trajnimit për GNV-të është 2 orë, ndërsa për KQV-të është mesatarisht 3 orë, e ndarë sipas mundësisë së organizimit në 2 orë për anëtarët e KQV-së, dhe 4 orë për kryetarët dhe sekretarët. Trajnimet e KQV-ve, do të zhvillohen nga trajnerë të organizuar në grupe, me jo më pak se dy trajnerë në secilin grup. Kohëzgjatja e trajnimit për monitoruesit e



fushatës zgjedhore është 3 orë ndërsa kohëzgjatja e trajnimit për operatorët e PEI-t dhe operatorët PEVN-së, është respektivisht nga 3 orë.

Trajnimet e operatorëve të PEI-t dhe PEVN-së, do të zhvillohen nga trajnerë të organizuar në grupe me jo më pak se dy trajnerë në secilin grup”.

2. Pika 7, e kreut X, ndryshohet si më poshtë vijon:

“7. “Vlera e pagesës për secilin trajner për një orë trajnimi është 750 (shtatëqind e pesëdhjetë) lekë, ndërsa për trajnerët e paorganizuar në grup trajnerësh dhe që zhvillojnë trajnimin në zonat e riskut, të përcaktuara si të tilla nga Drejtoria e Administratës Zgjedhore, është 1500 (njëmijë e pesëqind) lekë. Vlera e pagesës për një orë monitorimi është 300 (treqind) lekë”.

- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- III. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 10.3.2025 Nr: 250
Ora: 13:00



“Për disa ndryshime në vendimin nr.192, datë 5.11.2024,
“Për miratimin e programit për trajnimin dhe monitorimin
e administratës zgjedhore dhe të disa aktorëve të tjerë për
zgjedhjet për Kuvend 2025”